



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

AC-II-12-0151

Në çështjen juridike të :

I.M..K., nga Rahoveci.

Paditësi

Kundër:

1. Komuna.

2. Agjencisë Kosovare të Privatizimit(AKP), Rr. “Agim Ramadani” nr. 23, Prishtinë.

E paditura/Ankuesja

SH.P.K , me seli në Rahovec.

Përfaqësuar nga av. Q.Q.,

Ndërhyrësja/Ankuesja

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Sabri Halili gjyqtar kryesues, Mr.sc Sahit Sylejmani dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e AKP-së dhe ndërhyrësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit, nr. C.316/07 të datës 22.09.2005 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesat e AKP-së dhe SH.P.K “K”, aprovohen si të bazuara.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Rahovec, C.nr. 316/07, i datës 12 prill 2012.**

3. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit I.M.K. me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar në bazë të trashëgimisë i pjesës së parcelës kadastrale 973/1, në vendin e quajtur “ R”, me kulturë kullosë e klasës së IV, në sipërfaqe prej 1.19.69 ha, e regjistruar sipas fletës poseduese nr. 108, KK.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike

Paditësi I.K., me 19 prill 2005 kishte parashtruar padi pranë Gjykatës Komunale në Rahovec, për vërtetimin e pronësisë, kundër të paditurës Komuna. Paditësi kishte kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e tij si e bazuar dhe të vërtetohet se i njëjti është pronar në bazë të trashëgimisë të pjesës së parcelës kadastrale nr. 1015/1 në vendin e quajtur “R”, me kulturë kullosë e kl. IV, në sipërfaqe prej 1.05,00 ha, që evidentohet në fletën poseduese nr. 97 ZK

Paditësi më 16 qershor 2005, ka bërë zgjerimin dhe precizimin e padisë, duke e paditur edhe SH.P.K nga Rahoveci, pasi që kjo organizatë është si shfrytëzuese e pjesës së parcelës kontestuese. Gjithshtu, në vend të pjesës së parcelës kat. nr. 1015/1, në sipërfaqe prej 1.05,00 ha, nga lista poseduese nr. 97 ZK që është cekur në kërkesëpadi, duhet të jetë pjesa e parcelës kat. nr. 973/1, në vendin e quajtur “R” sipas kulturës kullosë e kl. IV, në sipërfaqe prej 1.05,00 ha, nga lista poseduese nr. 108, ZK .

Gjykata Komunale në Rahovec, me Aktgjykimin C.nr. 85/2005, të datës 22.09.2005, e ka aprovuar kërkesëpadi dhe e paditësit si të bazuar dhe ka vërtetuar se paditësi I.M.K. nga fshati Komuna është pronarë në bazë të trashëgimisë, në pjesën e parcelës kadastrale nr. 973/1, në vendin e quajtur “R” me kulturë kullosë e kl. të IV, në sipërfaqe prej 1.19.69 ha, nga fleta poseduese nr. 97, KK Xërxe.

Komuna, ndaj aktgjykimit të lartcekur, më 02 nëntor 2005 ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispoztave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të se drejtës materiale.

Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktgjykimin Ac.nr.497/2005, të datës 29.12.2005, e ka refuzuar ankesën e përfaqësuesit të Komunës si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Rahovec C.nr. 85/2005 të datës 22.09.2005.

Gjykata Komonale në Rahovec, me Aktvendimin C.nr 85/2005-1 të datës 24.01.2006, ka bërë përmirësimin e Aktgjykimit C.nr.85/2005 të datës 22.09.2005, ashtu që në dispozitiv të aktgjykimit, në fund të rreshtit të tretë ku është cekur fleta poseduese nr. 97, duhet të jetë nr. i fletës poseduese 108, KK.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), me 02 prill 2007 ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër Aktvendimit të Gjykatës Komonale në Rahovec, në lëndën kontestimore C.nr. 85/2005.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, me Aktvendimin e datës 04 tetor 2007, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e AKM-së dhe i ka prishur aktgjykimet e Gjykatës Komonale Rahovec C.nr. 85/2005 të datës 22 shtator 2005 dhe Gjykatës së Qarkut në Prizren AC.nr. 497/2005 të datës 29 dhjetor 2005, çështja juridike i është përcjell Gjykatës Komonale në Rahovec për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Gjykata Komonale në Rahovec, me Aktgjykimin C.nr. 316/07 të datës 12 prill 2012, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit I.M.K. së është pronar në bazë të trashëgimisë i pjesës së parcelës kadastrale 973/1 në vendin e quajtur "R", me kulturë kullosë e klasës së IV, në sipërfaqe 1.19.69 ha, e regjistruar sipas FP nr. 97, KK Xërxe, me dimensione: në anën lindore 92.27 m, në anën jugore 142.25m, në anën perëndimore 33.10m, në anën veri-perëndimore 211.43 m dhe në anën veri-lindore 4.56 m, të cilën të drejtë të paditurit janë të obliguar t'ia pranojnë. Gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar në bazë të nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore sipas së cilës dispozitë e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.

Më 22 qershor 2012, AKP-ja, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C.nr. 316/07 të datës 12 prill 2012, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesja pohon se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore që rrjedhin nga neni 182.2 (n) dhe neni 182.1

lidhur me nenin 7 al. (1,2 dhe 3) dhe nenin 3.3, dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit dhe se në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, sipas ankueses paditësi nuk e kanë bërë të besueshme se kanë pasur raporte juridiko-materiale me të paditurën, se e paditura ata i ka dëmtuar si dhe vihet në pikëpyetje legjitimiteti pasiv i të paditurës për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore. Ankuesi pohon se çfarëdo padie apo kërkesë që ka të bëjë me NSH në likuidim është në kompetencë të komisionit të likuidimit. Dhomës së Posaçme i propozon që ankesa e AKP-së të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit I.M.K. si e pa bazuar.

Më 21 qershor 2012, ndërhyrësi SH.P.K përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C.nr. 316/07 të datës 12 prill 2012, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesja pohon se gjykata ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182.2 nën paragrafi (f) dhe (n), gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë jo të plotë si dhe ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale në dëm të të paditurve dhe të palës ndërhyrëse. Ankuesi konsideron se gjykata është dashur ta ndërpres procedurën kontestimore dhe lëndën t'ia dorëzoj Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për shkak të hapjes së procedurës së likuidimit ndaj palës së paditur SH.P.K e cila është nën administrimin e AKP-së. Sipas ankuesit dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyetimin dhe se gjykata me aprovimin e kërkesëpadisë në formën dhe përmbajtjen çfarë është paraqitur në aktgjykim , gjykata paditësit ia njeh një të drejtë që nuk e ka pas as paraardhësi i tij dhe se me njohjen e kësaj të drejtë është në kundërshtim të hapur me nocionin juridik “askush nuk mund të bartë në tjetrin me shumë të drejta se sa që ka vet”. Dhomës së Posaçme i propozon që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit I.M.K. si e pa bazuar.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, ndaj ankesave të lartcekura ka parashtruar përgjigje, duke i kundërshtuar në tërësi si të pa bazuara dhe duke i propozuar Kolegjit të Apelit që të njëjtat ti refuzojë si të pa bazuara dhe ta vërtetoj aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Rahovec, C.nr. 316/07 të datës 12 prill 2012, me të cilin i është njohur e drejta e pronësisë në ngastrën kontestuese.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e AKP-së dhe e ndërhyrësit janë të bazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, Kolegji i Apelit, nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit për fitimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë për parcelën kadastrale 973/1 në vendin e quajtur "R", në sipërfaqe prej 1.19.69 ha, sipas fletës poseduese nr. 97 ZK pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit, Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182 par. 2, pika (n), pasi që dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyetimin e të njëjtit. Paditësi përmes parashtresës së datës 16 qershor 2005 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në atë mënyrë që objekt të kontestit ka paraqitur pjesën e parcelës kadastrale nr. 973/1 nga lista poseduese nr. 108 ZK . Gjykata në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar ka vendosur për pjesën e parcelës kadastrale 971/1 sipas fletës poseduese nr. 97 ZK , ndërsa në arsyetim flitet për pjesën e parcelës kadastrale nr. 971/1 sipas fletës poseduese nr. 108 KK , andaj sa i përket këtij fakti aktgjykimi i atakuar është kontradiktor dhe nuk dihet qartë se për cilën listë poseduese bëhet fjalë.

Gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke u dhënë besimin e plotë deklaratave të dëshmitarit F.Th. dhe H.K., por me një vlerësim të tillë nuk pajtohet Kolegji i Apelit, pasi që deklaratat e dëshmitarëve të lartcekur nuk mbështeten me asnjë provë tjetër që gjenden në shkresat e lëndës. Në rastin konkret deklaratat e dëshmitarëve si të vetme nuk mund të jenë bazë e mjaftueshme për të fituar pronësinë në parcelën kontestuese edhe për faktin se në shkresat e lëndës gjendet një deklaratë tjetër e dëshmitarit, tani të ndjerit H.K. me të cilën e zhvlerëson deklaratën e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.07.2005, e në bazë të së cilës bazohet vendimi gjyqësor i dhënë në shkallë të parë.

Sipas shkresave të lëndës, parcela kontestuese që nga viti 1952 e deri në vitin 2006 është evidentuar si pasuri shoqërore dhe asnjëherë nuk ka qenë në emër të paditësit, apo paraardhësit të tij. Paditësi me asnjë provë nuk e vërteton faktin e pretenduar se prona kontestuese para vitit 1952 ka qenë pronë e paraardhësit të tij. Kolegji i Apelit vlerëson se

gjykata e shkallës së parë është dashur t'i marrë parasysh këto fakte gjatë marrjes së vendimit merititor.

Me dispozitën e nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Juridike-Pronësore të cilën e ka zbatuar gjykata e shkallës së parë, janë caktuar bazat për fitimin e pronësisë, por nga shkresat e lëndës nuk rezulton se është përmbushur ndonjë nga bazat ligjore për fitimin e pronësisë, e veçanërisht fitimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë, prandaj vendimi i atakuar nuk mund të ketë efekt juridik për fitimin e pronësisë.

Sipas Ligjit mbi Trashëgiminë, objekt i masës trashëgimore mund të jenë sendet dhe të drejtat të cilat i përkasin individëve, ndërsa në rastin konkret sipas dokumentacionit, parcela kontestuese nuk i ka takuar paraardhësit të paditësit, por e njëjta është evidentuar si pronë shoqërore dhe atë që nga viti 1952. Pra, gjykata paditësit ia ka njohur një të drejtë në bazë të trashëgimisë që në rastin konkret nuk e ka pasur as paraardhësi i tij, andaj Kolegji i Apelit vlerëson se kërkesë padia e paditësit është aprovuar si e bazuar pa ndonjë bazë të mirfillt juridike dhe pa arsyetim ligjor të pranueshëm. Bazuar në provat në shkresat e lëndës, Kolegji i Apelit gjeti se kjo pronë tashmë është shitur tek personat e tretë dhe konform nenit 10 paragrafi 3, pika 1 e ligjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.06/L-086, asnjë vendosje e gjykatës nuk mund ta cenoj një bartje të tillë që ka ndodhur në një procedurë të rregullt dhe ligjore.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se ankesat janë të bazuara dhe rrjedhimisht aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet dhe padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

Ankuesit nuk i caktohet taksë gjyqësore për procedurën ankimore pasi që plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive në lëndët në pritje.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, më 15 gusht 2019.

Sabri Halili, Gjyqtar Kryesues _____

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Palët
- Gjyqtari i çështjes C.nr. 316/07 të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec.

Sabri Halili, Gjyqtar kryesues_____